



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Nr. 1298/Prot.

Tiranë, më 14.07 2023

V E N D I M

Nr. 69 datë 14.07 2023

" P Ë R
REDUKTIMIN E TARIFËS SË SHKOLLIMIT, PËR CIKLIN E TRETË TË
STUDIMEVE DOKTORATË NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS"

Në zbatim të Ligjit nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë-dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH pika 3/ç të nenit 3, të nenit 6 pika 28,29,30, të nenit 40, neni 77,78,79, në Statutin e UST, në Rregulloren e UST, në shkresën nr.90/2 datë 12.01.2023 "Kërkohe miratimi i kuotave për Ciklin e Tretë të studimeve në UST për vitin akademik 2022-2023", në shkresë nr. 90/3, datë 18.01.2023 "Informacion mbi përcaktimin e udhëheqësve për programet e ciklit të tretë Doktoratë në UST për kuotat e vitit akademik 2022-2023", në vendimin e Senatit Akademik nr. 27, datë 16.02.2023 "Për miratimin e rregullores për organizimin e programeve të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në UST", në shkresën e MAS nr. 2747 datë 27.04.2023 "Mbi kuotat e pranimit për vitin akademik 2023-2024", në vendimin e Senatit nr. 46 date 07. 04.2023 "Mbi miratimin e kuotave të pranimit, për vitin akademik 2023-2024 në UST", në Vendimin e BA nr. 32 datë 02. 05.2023 "Mbi miratimin e kuotave të pranimit, për vitin akademik 2023-2024 në UST" në shkresën e MAS nr. 203/2, datë 30 .06.2023 "Mbi listën e udhëheqësve shkencorë në programet e studimit të Ciklit të Tretë Doktoratë për vitin 2022-2023 ", Rektorati në mbledhjen e datës 14.07.2023

V E N D O S I:

1. Tarifat e aplikimit për aplikantët (FSHL,FVFR) dhe tarifat e regjistrimit të fituesve (FSHL,FVFR) për ciklin e tretë të studimit, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, për vitin akademik 2023-2024, të jetë sipas Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 22 datë 26-04-2022;
2. Të miratojë tarifën e shkollimit për studentët që do të ndjekin studimet në ciklin e tretë të studimit doktoratë për të dy fakultetet sipas tabelës bashkëngjitur;
3. Tarifa e shkollimit për ciklin e tretë do të paguhet me këste;

4. Tarifat vjetore të shkollimit për të tre ciklet e studimet do të bëhen publike në faqen zyrtare të Universitetit www.ust.edu.al;
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi Administratori i Universitetit të Sporteve të Tiranës, FSHL, FVFR, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore, Drejtoria e Marrëdhënive me Jashtë, Publikun dhe Studentëve.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet për miratim Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit.

REKTORI

Prof.Dr.Agron KASA



FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES

Tab. 1

Emertimi I Programit cikli I trete te studimeve Doktorate	Tarifa e shkollimit (per kandidatet nga stafi efektiv) në lekë	Tarifa e shkollimit per te tjere, ne leke
Shkenca Sportive (FSDL	400 000	800 000

Tab. 2

FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT

Emertimi I Programit cikli I trete te studimeve Doktorate	Tarifa e shkollimit (per kandidatet nga stafi efektiv) në lekë	Tarifa e shkollimit per te tjere, ne leke
Aktivitet Fizik dhe Shëndeti (FVFR)	400 000	800 000